



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1699 Prot.
15

Patos më 09.06.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.05.2026

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Klaudio Alisininaj
2. Liljana Mesutaj
3. Erald Çepele
4. Lori Musaj
5. Artan Velçani
6. Klarida Semanjaku
7. Armand Ahmetaj
8. Suela Hoxha
9. Ertila Myrtaj
10. Smerald Hazizaj
11. Elmira Rama
12. Renaldo Shpata
13. Vjollca Kasaj
14. Novrus Toska
15. Eduart Faslliaj
16. Gani Ahmetaj
17. Zejni Musaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Pjesmarrja në mbledhje është 17 këshilltarë.

Mbledhja bazohet dhe zhvillohet në bazë të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore si dhe Rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak,

Lexojmë rendin e ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.04.2026.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.04.2026.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për z. Pëllumb Bendaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “E Re”.
- 7-Projekt-vendim “Për miratimin e “Raporti Vjetor i konsolidimit të zbatimit të buxhetit dhe i Performancës për vitin 2025”.
- 8-Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.
- 9-Projekt-vendim “Për disa ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”
- 10-Projekt-vendim “Për shtim të dy punonjësve sezonal për masat parandaluese nga zjarri në pyje”.
- 11- Projekt-vendim “Për një ndryshim në V.K.B nr. 21, datë 29.03.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në bashkinë Patos.
- 12- Informacion mbi raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2026.

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua tju pyes nëse keni ndonjë kërkesë për të shtuar apo hequr nga rendi i ditës.

Çajup Refitaj- Kishim ne një kërkesë lidhur me një projektvendim “Për miratimin e listave të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për periudhat 2011-2014, 2015-2019, 2020-2024, të cilët përfitojnë nga Ligji 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”. E kemi kërkuar si jashtë radhe për vet rëndësinë dhe afatatet e zbatimit të këtij ligji kemi kërkuar që të futemi jashtë radhe në këtë rend ditë.

Arben Shpërdheja – siç e propozuam si ekzekutiv shtimin e punonjësve sezonal për masat parandaluese nga zjarret në pyje me kontratë të përkohshme për një periudhë 6 mujore, ju dërguam me shkresë kur bëmë këtë veprim këtë kërkesë pranë këshillit bashkiak, bëmë kërkesën për kalim fondi të produkteve AB dhe AD që është fondi kushtëzuar kur kemi ndihmë për qytetarët që u dëmtohen banesat dhe pjesa tjetër ishte për investimet. Përgjigja nga Ministria na erdhi sot konkretisht ku thuhet se kjo do të parashihet. Atëherë ne kemi kërkuar bashkimin e fondeve të kushtëzuar Ministrisë dhe na kthyen përgjigje me shkresën 4291 prot ku thuhet se kodi AB, mund të rishpërndahet sipas kërkesave tuaja vetëm në kodin AG që është kjo që po diskutojmë tani dhe duke përmbajtur kriteret e përcaktuara sipas Vkm 414, kërkesa e paraqitur nga ana juaj do të shqyrtohet dhe do të shikohet mundësia e propozimit për përfshirjen në aktet normative në vijim. Në këtë moment na e ngriu Ministria këtë pjesë dhe ekzekutivi kërkon të tërhiqet nga ky projektvendim për një moment të dytë.

Eduart Faslliaj- Ju thatë për miratimin e listës së debitorëve, unë nuk shikoj në material një listë të personave debitorë të cilëve u falen kamatvonesat. Do duhet bashkëshoqërues në material që ta dimë se unë të paktën përfaqësues i opozitës do doja ta kisha dhe duhet ta kishin dhe gjithë këshilltarët, për ti parë kush janë bizneset dhe qytetarët dhe pse mungon lista.

Çajup Refitaj- Praprakisht për shkak të volumit listën një nga këshilltarët është duke e shqyrtuar, gjithsesi do tju vihet në dispozicion prapakisht ne e kemi bërë publike listën në faqen e bashkisë dhe në rrjetin e fb aty për shkak të detyrimeve ne nuk kemi bërë publike vlerat.

Eduart Faslliaj- Unë mendoj që duhet të ishte në këtë formë për faktin që do duhej të ishte transparente dhe për vlerën.

Armand Ahmetaj- Do vihet në dispozicion tha drejtori, por duhet të kemi kujdes për përmendjen e emrave në publik, nuk duhet ti përmendim.

Eduart Faslliaj- Tani drejtori thotë i kemi publikuar në faqjen zyrtare të bashkisë ju thoni duhet të ruajmë emrat.

Çajup Refitaj-Emrat janë pa vlera

Armand Ahmetaj- Nuk vlen ti përmendim ne emrat këtu.

Eduart Faslliaj-mua më intereson ta kem atë listë me vlerat dhe emrat.

Armand Ahmetaj- Pika 13 e nenit 64 të rregullores na kërkon që shtimi i pikave kërkon 2/3 e numrit të këshilltarëve.

Lexojmë rendin nga e para duke vendosur pikat, pikën që u shtua dhe hequr atë që u propozua për tu hequr.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.04.2026.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.04.2026.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.

6- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për z. Pëllumb Bendaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “E Re”.

7-Projekt-vendim “Për miratimin e “Raporti Vjetor i konsolidimit të zbatimit të buxhetit dhe i Performancës për vitin 2025”.

8-Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

9-Projekt-vendim “Për disa ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”

10- Projekt-vendim “Për një ndryshim në V.K.B nr. 21, datë 29.03.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në bashkinë Patos.

11-Informacion mbi raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit.

12- Projekt-vendim “Për miratimin e listave të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për periudhat 2011-2014, 2015-2019, 2020-2024, të cilët përfitojnë nga Ligji 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”


Erald Çepele- duhet të votohet me vete pika shtesë, jo ti lexosh të gjitha bashkë.

Armand Ahmetaj- kush është dakord me pikat që lexova?

Miratohet me 16 vota pro, 1 abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1649 Prot.

6

Patos më 04.06.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.04.2026.

Armand Ahmetaj – Procesverbalin si material e keni pasur në dispozicion . Keni ndonjë vërejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit? Konsiderohet i miratuar në bazë të nenit 77 të rregullores.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Cori Musaj

Renaldo Shpate

Erkter Myrtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1649 Prot.

Patos më, 04 06.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.04.2026

Armand Ahmetaj – Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 29.04.2026 u morën gjithsej 2 vendime nga nr. 20 deri ne 21.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Cor: Musaj Maf
Rendito Shqeto
Gjithë Mirënjohja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1613 Prot.

13

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026”.

Armand Ahmetaj- Kjo pikë ka kaluar në komisionin e ekonomisë , ja jap fjalën ekzekutivit .

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 25 datë 18.05.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin 2026, të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Prill 2026 gjithsej 20 familje me një fond prej 74,725 (shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzetë e pesë) lekë.

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin prill 2026”.

Kush është dakord?

Eduart Faslliaj- Nuk na le të shpreheshim ne të komisionit fare kryetar

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Cori Musaj
Rendita Shkollë
Ertan Myrtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1614 Prot.

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 24 datë 18.05.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin mars 2026”, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Prill 2026 gjithsej 18 familje me një fond prej 61,160 (gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Lori Musaj – komisioni ekonomisë është mbledhur në datën 26 ka diskutuar mbi këtë pikë projektvendim dhe për projektvendimin që sapo kaloj pasi ekzekutivi relatoj ramë dakord se përmbajtja është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin prill 2026”.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 15694 Prot.
13

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës. Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për z. Pëllumb Bendaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “E Re”.

Arben Shpërdheja- Z. Pëllumb Bendaj ka paraqitur kërkesën me nr. 3360 prot., datë 06.11.2025, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “E Re” nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë financiare për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr.165, nr. 2649 prot., datë 01.09.2025

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Pëllumb Bendaj mbajti procesverbalin me nr. 3360/1 prot., datë 14.11.2025. Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur :

tavane rapote druri, dyer durali, dritare dural, parket(dysheme), rrjeti elektiknë një dhomë.

U hartuar edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë në vlerën 235,169. (dyqindë e tridhjet e pesë mijë e njëqindë e gjashtëdhjet e nëntë) lekë, referuar edhe “Vërtetimit për rënie zjarri” nr. 6 të datës 06.11.2025 lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit. Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës.

Bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja “a” me qëllim për të ndihmuar qytetarin Z. Pëllumb Bendaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t’i jepet një ndihmë financiare në vlerën 115,000 (Njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Armand Ahmetaj- Shprehe dhe njëhërë atë vleren se nuk dëgjohet në regjistrim.

Arben Shpërdheja- për të ndihmuar qytetarin Z. Pëllumb Bendaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t’i jepet një ndihmë financiare në vlerën 115,000 (Njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për z. Pëllumb Bendaj banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, lagjja “E Re”.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1643 Prot.
13

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

7-Projekt-vendim “Për miratimin e “Raporti Vjetor i konsolidimit të zbatimit të buxhetit dhe i Performancës për vitin 2025”

Mimoza Shtëmbari- Në zbatim të ligjit ekzekutivi ka hartuar dhe sjell për miratim raportin vjetor të konsolidimit të buxhetit dhe performancës për vitin 2025, ky raport përmban raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2025 i cili si informacion ka kaluar në këshill në shkurt të vitit 2026 dhe pasqyrat financiare të cilat dorëzohen e kanë afatin deri në 31 mars janë hartuar dhe janë dorëzuar pranë Ministrisë së Financave dhe tek thesari dhe gjithashtu edhe ndërmarrja vartëse dhe që të dyja këto pasqyra dhe zbatimi buxhetit bashkohen dhe përbëjnë një raport që quhet raporti konsolidimit i cili ka të gjitha treguesit realizimin, aktivet, pasivet, fondet që trashëgohen dhe investimet që janë në proces për vitin 2026.

Raporti është voluminoz, është dërguar, pjesë përbërse janë dhe rekomandimet të KLSH për vitin 2025 të cilat kanë qënë dhjetë rekomandime për raportin e performancës për vitin 2024 nga cilët janë realizuar 6, janë në ndjekje katër domethënë janë zbatuar 68% të rekomandimeve gjithashtu kemi dhe një raport të auditit të brendshëm i cili është pjesë e raportit konsolidimit ku janë zhvilluar nëntë auditime nga auditit brendshëm dhe kanë dhënë 33 rekomandime të cilat janë në proces zbatimi për të gjitha drejtoritë përkatëse sipas rekomandimeve, në mënyrë të shkurtuar ishte raporti i cili siç edhe e thashë përbëhet nga raporti monitorimit i cili ka kaluar në këshill dhe është informuar këshilli për gjithë vitin 2025 dhe është dhe pasqyra financiare të cilat konsolidohen menjëherë pasi dorëzohen në Ministrinë e Financave dhe degën e thesarit Fier.

Elmira Rama- edhe unë lexova raportin me vëmendje ishte një analizë goxha e detajuar me të gjitha të dhënat për secilën rubrikë, unë do të pyesja tani në lidhje me rekomandimet kishit edhe afatin kohor të përcaktuar keni një plan masash konkretë si procedoni për të mos mbetur vetëm në nivelin e evidentimit?

Mimoza Shtëmbari - atëherë unë ju them mbi procesin ju sqaroj mbi procesin e zbatimit të raportit të rekomandimeve si të jashtme dhe të brendshëm menjëherë sapo vjen raporti i rekomandimeve auditit jashtëm ose i brendshëm titullar i institucionit harton një plan masash dhe plan zbatimi dhe ja delegon të gjitha drejtorive dhe gjatë gjithë periudhave gjatë gjithë muajve në raportojmë pranë titullarit për ato që zbatohen dhe vështirësitë e atyre që nuk janë zbatuar dhe janë në proces.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e “Raporti Vjetor i konsolidimit të zbatimit të buxhetit dhe i Performancës për vitin 2025”

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1644 / Prot. 13

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një ndryshim të vendimit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

Mimoza Shtëmbari- me vendimin nr. 04 i cili është bashkëngjitur relacionit dhe projektvendimit në këshill është miratuar përdorimi i grantit performancës i cili zë vlerën tetë pikë tetë milion lekë i ndarë nga granti huaj dhe granti brendshëm sipas burimit të financimit nga pushteti qendror dhe ambasada zvicerane në vendimin numër 4 ne kemi kërkuar dhe miratuar përdorimin e vlerës të këtij granti prej 3 milion e 681 mijë për ta përdorur për blerje projektesh gjatë vitit 2026. Nisur nga kushtet e hartimit projekteve dhe nevojë më të madhe në prioritetet që ka bashkia kërkojnë që këtë vlerë ta kalojnë në rikonstruksionin e rrugës Manxharaj Gjinoqarë ti shtohet vlerës së miratuar me buxhetit fillestar në vendimet e këshillit bashkiak

Gjithashtu pika e parë këtu është saktësimi emërtimit përfundimtar të projektit krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re. Në vendimin numër 4 emërtimit këtij projekti për vlerën tjetër që kishim vendos për ta përdorur në këtë si shtim ishte emërtimi krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re (fusha e basketbollit) duke qenë se këto janë brenda krijimit të këtij parkut rekreativ kërkojmë të saktësohet vlera dhe të quhet një investim, është një investim dhe një projekt.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë e cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt- Për një ndryshim të vendimit nr. 04, datë 30.01.2026 “Për miratimin e përdorimit të grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Renaldo Shydo
Erbiter Myrtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1645 Prot.

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për disa ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”

Juela Shpata – sot paraqesin për miratim projektvendimin numër 27 datë 19.05.2026 “Për një ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”, pas ndryshimit të pagës minimale në muajin janar ka pas disa kërkesave të bashkive është ndryshuar dhe pika 11 e VKM 328 që trajtohen pagat të administratës për punonjësit administrativë në VKM e mëparshme ka qenë pika 11 shprehej se disa punonjës mund të trajtoheshin profesionistë mund të trajtoheshin nga 40 në 47 maksimumi ishte 47 i nivelit me ndryshimin e pagës minimale ka kaluar 50 deri në 57 sot kërkojmë prej jush miratimin e ndryshimit të nivelit të pagës për magazinieren e magazinës qendër të bashkisë Patos për të mar maksimalen e kësaj pike 57.

Lori Musaj – në mbledhjen e komisionit është diskutuar dhe kjo pikë dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për disa ndryshime në V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave në bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

Eduart Faslliaj- Për një sqarim të vogël për pikën që kaluam sepse unë jam dakord që të shkoj se ne e diskutuam dhe në komisionin e ekonomisë po thjesht doja të pyesja sekretaren na lejon ligji kur themi miratojmë nivel pagash dhe në këtë rast kemi vetëm një pagë specifike për person, kuadri ligjor na lejon bëhet fjalë vetëm për një vend pune nuk është nivel pagash në pozicionin e magazinieres ne kemi disa magazinier dhe në këtë rast na duhet dhe po marrin vendim për një vend pune të specifikuar jo për gjithë magazinieret, na lejon ligji se sjemi për nivel pagash por vetëm për një pagë konkrete.

Juela Shpata – po sepse magazinat e ndërmarrjes janë të përfshira në VKM e pagës minimale atë që ne kemi kaluar një janar ndërsa në këtë pikë të vkm-së patjetër që ne duhet futemi për miratim.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj
Benedto Shpata
Eshita Myrtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1644 Prot.

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një ndryshim në V.K.B nr. 21, datë 29.03.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në bashkinë Patos.

Juela Shpata – ekzekutivi propozon të miratojë rishikimin e Programit të Transparencës të bashkisë Patos në përputhje me modelin e miratuar me urdhërin nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale. Konkretisht bashkëlidhur projektvendimit është lidhja nr. 1 dhe ndryshon pika 8 në të cilën përshihet këshilli bashkiak

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e dhjetë Projekt-vendim “Për një ndryshim në V.K.B nr. 21, datë 29.03.2024 “Për miratimin e Programit të Transparencës në bashkinë Patos.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Rendebër Shpata

Erklot Myrtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1648/2 Prot.

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

11- Informacion mbi raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit.

Mimoza Shtëmbari- Grupi menaxhimit strategjik harton raportet e monitorimit në çdo 4 mujor dhe paraqet për informim në këshillin bashkiak

Gjatë hartimit të këtij raporti të zbatimit të buxhetit grupi menaxhimit gjithmonë ka pasur në fokus qëllimin e buxhetit orientimet dhe prioritetet e buxhetit të 2026 të cilat janë miratuar në këshillin bashkiak, burimet që përbëjnë buxhetin për katër mujorin e parë të vitit 2026 janë vlera 733 milion 839 mijë të cilat janë miratuar me buxhet fillestar në këshill me vendimin numër 82 datë 17.12.2025, buxhetit i është shtuar dhe fondi si shtesë nga fondet e trashëguara 137 milion 564 të cilat përbëhen nga 63 milion nga transferta e pa kushtëzuar 45 nga të ardhura e trashëguara dhe 28, 290 nga granti sektoriale gjithashtu edhe si shtesë vjen dhe granti performancës të cilën e trajtova edhe të vendimi që është miratuar me vendimin me nr. 4 me vlerën 8.8 milion lekë i ndarë sipas burimit financimit

Për katër mujorin e parë të vitit 2026 kemi një realizim të burimeve 335 milion 276 mijë lekë dhe realizim të shpenzimeve 172 milion 238 mijë lekë.

Kjo është paraqitur në tabelën që shoqëron raportin sipas kategorive të cilat përbëhen nga transferta pakushtëzuar, sektoriale fondet e kushtëzuara granti dhe përqindja e realizimit për çdo burim.

Gjatë këtij 4 mujori kemi pasur ndryshimeve me vendim të këshillit bashkiak vendimi këshillit numër 4 për përdorimin e grantit të performancës vendimi numër 10 për miratimin e nivel të pagave për bashkinë dhe ndërmarrjet vartëse që është për efekt të pagës minimale si dhe vendimi numër 11 për rehabilitimin e rrugës Saliq Grizë Lënginas, në raport është përfshirë realizimi të ardhurave sipas kategorive taksave dhe sipas kategorive taksave tarifave të cilat janë miratuar në paketën fiskale dhe në total realizimi të ardhurave krahasuar me planin vjetor krahasuar me katër mujorin e parë është 19%, referuar shpenzimeve sipas programeve struktura e buxhetit për vitin 2026 është me gjashtë programe, është planifikimi menaxhim administrimi i realizuar 29% krahasuar me planin total, siguria publike 21%, zhvillimi ekonomik 6% gjithmonë krahasuara me planin vjetor, çështjet sociale arsimit dhe kultura 20% gjithashtu ne kemi fonde të kushtëzuara të cilat i përkasin kategorive për të cilat ne i administrojmë fondet për pagat e Gjendjes Civile fondet për pagesat e invalidëve dhe të paafteve, fondet për ndihmën ekonomike kemi fondet për investime nga pushteti qendror që i përkasin objekteve shkollës Sotir Çapo, ujësjellësi të Magjistratit loti i dytë dhe fondin rezerve dhe kontigjencës të cilët me vendimin e këshillit për miratimin e nivelit pagave e kaluam për të mbuluar efektin financiar nga rritja e pagave për zbatimin e këtij vendimi Në raport janë trajtuar dhe paraqitur të gjitha investimet që janë miratuar nga këshill bashkiak për statusin ku ndodhen dhe sa janë realizuar.

Këto ish-in të përmbledhura në këtë raport

raportin e monitorimit të zbatimit të katërmujorit të parë do të gjeni publikuar në faqen e bashkisë dhe në faqen e Ministrisë së Financave.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër? Nëse skemi kalojmë në pikën tjetër.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1743 Prot.

Patos më 04 06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.05.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e listave të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për periudhat 2011-2014, 2015-2019, 2020-2024, të cilët përfitojnë nga Ligji 86/2025 "Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë"

Çajup Refitaj- ky projektvendim konsiston në miratimin e listave të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për periudhat 2011-2014, 2015-2019, 2020-2024, të cilët përfitojnë nga falja e Ligjit 86/2025 "Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë"

Kokën e vendimit të kemi hartuar në përputhje me mënyrën që ka përcaktuar ligji për faljen e kemi ndarë atë me periudha sipas ndarjes dhe përcaktimit që ka bërë ligji 2011- 2014 është periudhe e cila fshihet falet ose shuhet pa kushtet që do të thotë taksapaguesit të dy kategorive qofshin ato biznes apo individë familjar nuk kanë detyrim që të paguajnë principalin e këtij detyrimi dhe ky veprim do të kryhet nga vetë administrata e taksave të bashkisë pra administata e takasave vendore periudha tjetër është 2015-2019 kjo është një periudhë e paraparë me kusht nga ligji dhe kushtet janë ndarë sipas kësaj forme në afatin e pagesës afati i parë është 30 qershori pra kush paguan brenda këtij afati falet 50% e principalit dhe nëse paguhet deri në 31.12 e këtij viti që jemi brenda atëherë falet 25% e principalit

Në këto kushte e kemi kërkuar edhe jashtë radhës sepse afatet sikurse i dhe më sipër janë pak po themi të shkurtra nga ana administratës është punuar për verifikimin dhe nxirrjen e gjithë debitorëve qofshin këto individë familjar ashtu dhe biznes të ndara sipas periudhave dhe vlerat përkatëse listën e cilës e kemi vënë në dispozicion, deri diku të cunguar për shkak të faktit sepse kemi qenë të detyruar për duke qenë se kjo ishte voluminoze për ndarjen dhe klasifikimin debitorëve këtu në projekt vendim janë përcaktuar dhe vlerat përkatëse për secilat nga periudhat që citova më sipër ku për verifikimi i parë i detyrimeve papaguara të papaguara përcaktuara dua të citoj dhe këtë që ligji objekt i faljes së ligjit 86-2025 janë të gjitha taksat dhe tarifat vendore të përcaktuara nga ligji 9632 30.10.2006 për sistemin e taksa vendore dhe jo marrëdhëniet tjera që krijon pushteti vendor në raport me veprimtarinë e tij qofshin këto civile apo dhe marrëdhënie apo dhe tarifat të cilat nuk janë objektit këtij ligji por janë objekti ligjeve të tjera.

vlera për këtë periudhë është 39,118,458.4 (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë katër) lekë pra periudha 2011-2014 e cila falet pa kusht. Janë verifikuar detyrimet për periudhën 2015-2019 të cilat kapin një stok detyrimi në vlerën 61,992,261 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, kjo shifër është shifër e cila ka në brendësi të vetë të dy kategoritë si atë biznes dhe atë familjarë këtu është përcaktuar dhe mënyra dhe modaliteti që thamë nëse detyrimi taksapaguesit vendosin ta shlyejnë brenda 30. 6 atëherë falet 50% e detyrimit në të kundërt nëse paguajnë 31.12 i falet 25% e detyrimit.

Pika 3 e këtij projekti është verifikimi dhe nxjerrja e debisë për periudhën 2020-2024 ku ligji ka përcaktuar faljen e të gjitha kamatvonesave që vijnë mbi principalet të këtij detyrimi po principi nuk falet pra gjoha dhe kamat vonesat e aplikuara mbi detyrimin e kësaj periudhe falen dhe shuhen plotësisht me kusht pagesën e principalit vlera e kësaj debie për këtë periudhë është 122,999,159.99 (njëqind e njëzet e dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë, këto vlera janë të detajuara dhe analitike si për individë pra taksapaguesit individë ashtu edhe ata biznes që janë pjesë përbërëse e listës ashtu sikurse e theksova dhe në fillim objekti punës të komisionit të ngritur për zbatim e këtij ligji ka qenë dhe publikimi i këtyre listave që tani janë bërë publike për të qenë transparent në proces dhe këto lista janë publikuar sipas periudhave pra ashtu sikurse kemi kërkuar dhe nga ju të ndarë me periudha është bërë dhe publikimi i këtyre listave.

Novrus Toska – nga këndvështrimi im se normalisht nuk e gjej dot këtë vendimmarrje këtë ligj por unë shikoj më shumë çal me shumë mangësi miratimin e këtij ligji dhe zbatimin e tij tani kjo i vë në kushtet të pabarabarta taksapaguesit

E para unë kam një pyetje në raport me numrin e përgjithshëm 100% e taksapaguesve sa përqind përbëjnë këta që marrin falje tani? dhe kjo për mendimin tim nuk do të ndihmojnë punën e bashkisë të administratës bashkisë në mbledhjen e të ardhurave në vazhdimësi ky është mendimi im se sot është një përqindje x që nuk paguajnë taksat në të ardhmen do jenë më shumë . Ketu gjeta dhe emra këshilltarëve që nuk kanë paguar dhe në të ardhmen do këtë më shumë.

Suela Hoxha- dakord në fakt me parafolësin për vetë faktin se të njëjtën pyetje ndoshta do kisha edhe unë që për të qenë transparente na intereson dhe qytetarëve dhe më konkretisht çfarë do të ndodhë me ata qytetarë që kanë paguar deri tani rregullisht taksat dhe tarifatat dhe kjo realisht është një precedent nxitës për të ardhmen e taksave në bashki pra kjo nuk është në favor atëherë duam një përgjigje konkrete

Cfarë do të ndodh me këta që kanë paguar tani dhe përqindja është shumë e rëndësi domethënë që sa përqind kanë paguar dhe sa jo.

Artan Velçani - ne miratojmë një list që rrjedh nga ligji që është miratuar atje kur e merituan ligjin ata e bënë këtë debat ata, te lista kemi ndonjë problem ne aty te heqim ndonjë e të vëmë ndonjë, nuk e kemi dot këtë mundësi kështu qe une e quaj të ezauruar këtë nuk e kemi dot fuqinë, ligji e ka përcaktuar që faljen tarifatat dhe taksat

Suela Hoxha - puna është ato ndodh me ata që kanë paguar këtu e kemi ne në dorë për të bërë diçka.

Eduart Faslliaj – ligji është nxitës prevazor dhe nuk është stimulues për ata qytetare apo bizneset që kanë paguar në këtë mënyrë ligji nxit që ata të vazhdojnë rrugën e mospagesës por jam dakord edhe me Artanin që ne jemi të detyruar që ta zbatojmë sepse nuk na ngele ne për të interpretuar po unë kisha një pyetje për administratën tatimore tonë të bashkisë çka masa ka marrë administrata jonë dhe çka ka në dorë për ti shtrënguar që mos të na ndodhë kjo gjëja prapë sepse sikurse e tha dhe Novruzi dhe duket ajo me një shikim që ka këshilltar, administratë bashkie që nuk kanë paguar detyrimet kemi ne në dorë dhe mesa pash një pjesë e biznese janë një pjesë e tyre ishin me debi por nuk janë aktivë , përpara se ta mbyllin biznesin a ka në dorë administrata që ata mos të mbyllin dot dokumentacionin?

Elmira Rama – asgjë në kundërshtim me ligjin siç e thanë edhe kolegët por thjeshtë do t'i sillja administratës së bashkisë në vëmendje ato fletat zarfat e taksave që i kemi shpërndarë edhe tre katër ditë para vitit të ri dhe unë sapo e pash këtë vendim mu kujtua një familje edhe emrin e secilës nuk e gjeta aty në listë që i ka paguar nuk e di ku ka marrë borxh apo si është rregulluar ajo familje dhe bashkohem me atë që tha Novruzi është e padrejtë.

Eduart Faslliaj- Kisha një pyetje për këshilltarët që nuk binin dakord a do ta votojnë apo jo?

Vjollca Kasaj – është një shifër alarmante aty që nuk kanë bërë pagesa të taksave dhe bashkia duhet të ishte më e ndërgjegjësuar në veprim për të parë reagimin dhe ti bënte këta qytetarë që të paguanin taksën si të tjerët është shifër shumë e lartë

Artan Velçani – ne mund të mos miratojmë listat për ndonjë arsye teknike por për gjitha opinionet e tjera që janë të drejta dhe të vërteta në përgjithësi në menaxhimin e shtetit ndodhin këto të karakterit financiar, tani ne duhet ti shikojmë me radhe se ka dhe raste që mospagesat kanë pasur një arsye.

Smerald Hazizaj - një VKM e ardhur cilado qoftë vendimi marrë e mospagimit të taksave nuk e inkurajoj që të vazhdoj në vazhdimësi përderisa ka por ju siguroi që këtu me sa vura re unë te ajo lista e parë në faqen e bashkisë Patos ka dhe familje të cilët sot për një arsye për një arsye tjetër janë ndarë familja babai me mamane ka djalin djali është ngarkuar me taksat pa çka se është banor i së njejtës familje, pra nuk shoh ndonjë alarmante pa çka se të gjithë qytetarët që kanë paguar detyrime të tyre normale kanë zbatuar rregulloren dhe ligjin por edhe kjo vlerë krahasuar për vitet që ka këtu nuk është ndonjë vlerë kushedi sepse këtu janë familje dhe këtu janë dhe emigrantët përfshirë

Siç e thashë më sipër këtu ka dhe banorë të cilët janë shkëputur ndoshta edhe një dy tre kanë krijuar kurora të tjera brenda një familje të cilët këto janë detyruar të bëjnë pagesë unë ju siguroj që banesën e ka po ka dy kurora , këtu ligji e detyron familjen të krijojë brenda një banesë dykurora me detyrime të përcaktuara për dy kurorë pra një banesë do paguaj dy herë detyrime.

Çajup Refitaj- është bërë një raport midis grupeve sipas pyetjes tuaj dhe ne jemi në raportin e 60% me 40. 60 kanë qënë ata të cilët kanë qënë taksapaguese të rregullt për këtë periudhë dhe 40 ata të cilët sot ne i kemi në lista debitor

lidhu me pjesën e impaktit të ligjit dhe nuk mundet që të japim opinionit tonë në jemi duke qënë se jemi një administratë brenda një administratit të një shtetit jemi të detyruar të zbatojmë këtë ligj të jemi korrektë në raportet dhe unë ju sigurohej që sot infrastruktura që ka bashkia patos nëpërmjet strukturës së taksave e ka një strukturë komode e cila ka verifikuar dhe ka mbaruar këtë proces nëpërmjet evidentimit përcaktimit për të gjithë po themi bazat e tatueshme duke filluar nga banesat apo dhe pjesa po themi sipërfaqes tokës bujqësore përbërës familjare etj pra ky është një proces që natyrisht do kalojë me një transparencë të plotë sepse komisioni për të cilin është ngritur zbatimi i ligji e zbaton detyrën e tij deri në datë 31.12 ashtu sikurse dhe sot që ne paraqesin për miratim pranë jush listat e këtyre debitorëve do vijnë dhe në kërkesat tjera të cilat do jenë pjesë e objektit të punës së grupit të punës ngritur për këtë pra pas hapin të gjitha hapat e përcaktuar në ligj dhe ato që do jenë pjesë e kërkesës ligjore dhe kompetencës suaj do kalojnë pranë jush për kërkesë.

Armand Ahmetaj- Ne sot në sot miratojmë efektet që do të vijnë ligj në zbatimin e programit për mbledhjen e detyrimeve sepse këtu brenda këtyre detyrime nuk janë vetëm ato të bashkisë ka dhe detyrime të tjera, ne po flasim pjesën tonë ne sot miratojmë efektet e programit për mbledhjen e detyrimeve

Çajup Refitaj- për të qartësuar vlerat e debive që ne kemi përcaktuar nuk janë ato të cilat falen dhe shuhen, këto janë vlera cilat do kalojnë sipas hapave që ka të përcaktuar ligji kjo vlera që falet pa kusht shuhet e gjitha pjesa tjetër do merrët 50% dhe pjesa tjetër 100%.

Nuk parashikohet në asnjë ligj që ata që kanë paguar të kompensohen natyrisht edhe ky edhe ky ligj jo sepse ajo quhet kredi tatimore dhe ligji nuk e ka parashikuar këtë pjesë ne nuk duhet që të hapim një panik të këtij tipi sepse detyrimisht taksapaguesit qytetarë ne do punojmë të ndërjegjësojmë pjesën nuk ka dënjuar të kryej detyrimet por jo që të stimulojmë ata që kanë paguar e ti kthejmë

Pjesa e bizneseve pezulluara sipas tij ne e kemi përcaktuar statusin e tyre në atë listë që ju keni në dispozicion por këto biznese nuk përjashtohen nga bizneset e tjera që kanë detyrime pra do këtë të njëjtën mënyrë të trajtimit ndërsa ata grupit të cilët janë të regjistruar pra që nuk funksionojnë më ata do të trajtohen dhe detyrimet e tyre do të fshihen nga 2011 deri në 2024 të regjistruarit për ata me status të çregjistruar dhe ne këtë e kemi paraqitur dhe një listë të veçantë.

Eduart Faslliaj- Nëse një biznes ka ndërprer aktivitetin e vet është debitor në bashki do të mari statusin I pezulluar ose do cregjistrohet administrata tatimore e bashkisë ka fuqi ligjore që mos ti japi dokumentacionin që të kryej cregjistrimin e pezullimit pa bërë pagesën?

Çajup Refitaj- po ne kemi një marrëdhënie me qkb sepse aplikimet kryhen online në të dy rastet qkb na drejtohet zyrtarisht për situatën e detyrimeve për secilin nga bizneset të cilët aplikojnë për pezullim apo cregjistrim, nga ana jonë kthehet përgjigje negative dhe në këtë mënyrë qkb e refuzon deri në shlyerje.

Eduart Faslliaj- Pash që ekzistojnë kompani që rezultojnë të pezulluara apo cregjistruara që ishin debitore dhe për 4 vjecarin e fundit.

Çajup Refitaj- Vlera e bizneseve të cregjistruara është 31 mijë 274 lekë vlera e debisë e kësaj kategorie që një pjesë e tyre kanë në përbërje që janë kamat vonesa të tipit pagesa të detyrimit dhe normalisht administrata nuk ka mundur që ta japë komunikimin që ka bërë me qkb sepse momenti i pagesës me momentin e kamatës është një vlerë e papërfillshme. Në total nr i debitorëve shkon 4686. Kur jetojnë dy familje në një shtëpi taksën e truallit dhe ndërtesën ja faturojmë pronarit dhe pjesa tjetër ne e tarifojmë për tarif shërbim dhe pastrimi. Pjesa e emigrantëve kur kanë një pronë në Patos janë të detyruar ta paguajnë.

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e dymbëdhjetë Projekt-vendim “Për miratimin e listave të debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për periudhat 2011-2014, 2015-2019, 2020-2024, të cilët përfitojnë nga Ligji 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë”

Kush është dakord?

Erald Çepele është larguar nga salla

Miratohet me 15 vota pro, abstenim ska, 1 kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Zori Musaj
Reinaldo Shpeke
Enxhel Myrtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj

